



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Hani i Elezit
Municipality Assambly of Hani i Elezit

01/ Nr.6261 /2012

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 24, 40 (të shpallur në Gazetën Zyrtare Nr. 28/2008), Ligjin Nr.04/L-079 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012 neni 2, Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit Nr.03/L-48 neni 20, Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal nr.03/L-49 neni 2, Qarkorja Buxhetore 2013/02 për Komuna të datës 27.07.2012, Rregulloren e Punës së Kuvendit neni 15 shkronja (b), Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 27.09.2012 mori:

VENDIM

PËR

MIRATIMIN E BUXHETIT PËR VITIN 2013 DHE PARASHIKIMET BUXHETORE PËR VITIN 2014-2015
TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT

I

Buxheti i përgjithshëm i Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2013 është në shumë prej 1.832.040 €, ndërsa parashikimet për vitin 2014 janë në shumë prej 1.869.512 € dhe për vitin 2015 në shumë prej 1.904.631 €.

II

Në strukturën e të hyrave të tërësishme buxhetore për vitin 2013 sipas pikës I të këtij vendimi, mjetet nga grantet qeveritare janë në shumë prej 1.482.040 €, shënojnë pjesëmarrje me 80.90% dhe nga të hyrat vetanake komunale prej 350.000 €, me një pjesëmarrje prej 19.10% në strukturën e përgjithshme të buxhetit.

III

Shpenzimet e përgjithshme buxhetore për vitin 2013, sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve parashikohen të kenë këto ndarje: Paga dhe Mëditje 1.043.088 €, Mallra dhe shërbime 174,168 €, Shpenzime komunale 37.500 €, Subvencione dhe transfere 32.000 € dhe Shpenzimet kapitale 545.284 €.

IV

Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit nga kuvendi i komunës.

V

Me këtë vendimi njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Ministria e Financave, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data:27.09.2012

Kryesuesi i Kuvendit
Menduh Vlasi

